Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0615

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "A.R.F."SH.P.K., me Nr. Protkolli 615/23 të datës 25.08.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 11.08.2023 të Kuvendi Komunal Malishevë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues(AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS me numër të prokurimit 62500-23-6661-1-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve, me datë 06.10.2023 merr këtë:

Vendim

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "A.R.F." SH.P.K. me Nr. të protokollit 2023/0615, e datës 25/08/2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 11.08.2023 Kuvendi Komunal Malishevë nga cilësia e tij si Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS" me numër të prokurimit 62500-23-6661-1-2-1, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i tarifave të ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.06.2023, Kuvendi Komunal Malishevë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS me numër të prokurimit 62500-23-6661-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 54,883.63 €.

Me 11.08.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë "INFINIT" SH.P.K. Me 16.08.2023, OE "A.R.F." SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Me datë 17.08.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit ekonomik ankues dhe ka vërtetuar Vendimin e lartcekur.

I pakënaqur me Vendimin e AK-së, Operatori ekonomik "A.R.F." SH.P.K, me datë 25.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 615/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankese sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues A.R.F. SH.P.K. lidhur me eliminimin e tyre janë parashtruar si në vijim**: "***Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Malishevë me datën 11.08.2023 ka publikuar vendimin e AK-se ku e shpërblen me kontratë një OE me të shtrenjtë sesa ne, me çmim gati dyfish me të shtrenjtë sesa çmimi që kemi ofertuar nga ana jonë, dhe na dërgon letrën standarde si tenderues i eliminuar. Konform nenit 59 dhe 72 AK është dashur të kërkoj sqarime e jo menjëherë të na eliminoj pasi që gjatë ngarkimit të tenderit tonë e kemi gabuar certifikatën në vend që ta ngarkojmë certifikatën e re e kemi ngarkuar të vjetrën kjo gjë mund ti ndodh çdokujt dhe AK është dashur të kërkoj sqarime edhe konform nenit 10.1 të Udhëzuesit : A02 Udhëzues Nr-001/2023 për prokurimin publik të KRPP-së. Në momentin që AK do te kishte kërkuar sqarime dhe ne menjëherë ja kishim dërguar certifikatën e re të cilën e kemi vazhduar menjëherë në kontinuitet me certifikatën e vjetër pra sqarimet do të ishin komplet në përputhje me nenin 72 të LPP. Pra ne e kemi certifikatën e vazhduar me validitet para datës së dorëzimit të tenderit që shumë lehtë mund të verifikohet si nga data e lëshimit ashtu edhe nga data e noterizimit të kësaj certifikate të cilën po e bashkëngjisim në këtë kërkesë për rishqyrtim. Pra siç po shihet në të gjitha mënyrat AK e ka të lehtë ta vërtetoj se certifikata është e lëshuar*

para datës se dorëzimit të tenderit ku edhe në këtë rast data e lëshimit të fundit është 26.062023. Pra siç shihet ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e AK-së të publikuara ne NJK dhe DT dhe kemi dhënë çmimin më të lirë pasi që edhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Në përgjigjën e kërkesës tonë për rishqyrtim AK nuk ka dhënë kurrfarë arsyetimi as edhe një fjalë të vetme. Një veprim i tillë i AK-së është në kundërshtim të plotë me nenin 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve ku thuhet "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.AK fare nuk e ka arsyetuar vendimin për refuzim.AK në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.Gjithashtu shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se: Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo - diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Si dhe në piken 2 thuhet: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe me Çmimin më të ulët."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE A.R.F. SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 28.08.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 615/23 ndërsa me datë 08.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Me OE "A.R.F." SH.P.K. ka deklaruar se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues. Ndërsa AK ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues duke pohuar cituar: "*Ne si AK nuk pajtohemi me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ne kemi vepruar konform rregullave dhe ligjit të LPP-së. Duke respektuar nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së ku citon: Mungon certifikata ISO 9001 mund të kërkohet informata sqaruese. Ndërsa OE ne fjalë e ka ofruar certifikatën ISO 9001 jo valide që do të thotë se ISO në fjalë e ka ofruar po e ka jo valide.*"

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertëve, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "A.R.F." SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0615 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimor është cilësuar si i bazuar pasi që *Ankuesi pretendon se ka dorëzuar në ofertën në mënyrë të gabuar certifikatën ISO 9001-2015 me afat të skaduar. Duke u bazuar në atë se çfarë është pretenduar, sipas LPP-së, neni 59 pika i dhe ii thotë si në vijim: "Autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.*

Po ashtu neni 72 i LPP-së, pika 1 thotë se: "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".

Duke u bazuar nga ajo çfarë u sqarua më lartë eksperti shqyrtues sqaron se AK është dashur që në bazë të neneve të përmendura më lartë të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues në lidhje me certifikatën e dorëzuar me afat të skaduar dhe jo të eleminoj në mënyrë direkte Operatorin Ekonomik, pa kërkuar fare sqarime. E rëndësishme është që data e lëshimit të certifikatës të jetë para datës së hapjes së tenderëve, ashtu siç e kërkon edhe Ligji për Prokurimin Publik.

Po ashtu eksperti konsideron se AK- "Kuvendi Komunal Malishevë", në vendimin e kërkesës për rishqyrtim nuk i është përmbajtur nenit 108/A të LPP-së, sepse në vendimin e nxjerrur si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim, së pari nuk e ka arsyetuar fare se përse po refuzohen

pretendimet e kësaj kërkese si dhe nuk e ka përfshirë fare as pjesën e kështillës juridike në fund ashtu siç është dashur.Andaj duke parë këtë çfarë u sqarua, më lartë, vlerësojmë se pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues A.R.F. SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit.

Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues A.R.F. SH.P.K. i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit dhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues A.R.F. SH.P.K. janë të bazuara**.**

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së pasi që nuk ka kërkuar të dorëzoj/plotësoj/sqaroj, dokumentacionin nga Operatori ekonomik ankues brenda afatit të caktuar kohor, po ashtu nuk ka vepruar edhe në haramoni me nenin 108/A të LPP-së ngase vendimin e publikuar si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim, nuk ka arsyetuar se përse po refuzohen pretendimet ankimore të Operatorit ekonomik bazuar në prova dhe argumente konkrete.

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, pa nevoj që të njejtat të citohen sërish, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Malishevë të datës 11.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS" me numër të prokurimit 62500-23-6661-1-2-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim.**

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe jo të shoh ligji në mënyrë selektive andaj bazuar ne pretendimet ankimore dhe atë qe u përshkrua si me larte, PSH vendosi qe kjo procedure e prokurimit te kthehet ne ri vlerësim me qellim që të trajtohen ne mënyrë te drejte kërkesat, kundrejt ofertave sipas dispozitave dhe parimeve te prokurimit publik ne fuqi sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vlerëson se Autoriteti Kontraktues

gjatë vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Njëkohësisht e obligon Ak që gjatë rivlerësimit të ofertave të veproj konformë FDT dhe njoftimit për kontratë, si dhe të vlerësoj drejtë ofertat e operatorëve ekonomik në harmoni me nenit 7, 72, 59, 69 të LPP lidhur me nenit 40, te RRPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh edhe nenin 59 paragrafi 4 se edhe nëse do të kishte lëshime të vogla eventuale, që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara me njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, për panelin shqyrtues do të konsideroheshin jo të rëndësishme në raport me interesin publik dhe fondet publike, e për të cilat fonde dhe burime publike, autoritet kontraktuese janë të obliguara ti përdorin në mënyrë ekonomike.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siq parashihet në nenin 6 të LPP-ës, Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimin të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese ne Republikën e Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke respektuar dhe duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**
- OE - **A.R.F. SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: